

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 576 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

VENDIM Nr. 32, datë 20.05.2016

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Vëzhgime përnjohëse në zonën kodrinore të Shqipërisë, veri-perëndimore (Lezhë-Shkodër)**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Dr. Rovena Kurti,

VENDOSI:

1. Të miratojë Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Vëzhgime përnjohëse në zonën kodrinore të Shqipërisë, veri-perëndimore (Lezhë-Shkodër), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Dr. Rovena Kurti, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kërkimet do të përqëndrohen në lindje mbi « Fshatin e Ri ». Në veri të kurrizit të Rrencit, do të plotësohet zona e pambuluar në fshatin Pentar dhe në fshatin Mal Kolaj, ku ka mbetur dhe pjesa më e madhe e tumave të padokumentuara.
 - Vëzhgimi arkeologjik (survey) do të shtrihet këtë vit më në veri, për të plotësuar vijën kodrinore bregdetare deri në kufi me Malin e Zi. Konkretisht do të vazhdohet në zonën e Anamalit në kodrat që ndodhen në perëndim të malit të Taraboshit, duke filluar nga Buna në jug deri në kufi me Malin e Zi.
 - Do të dokumentohet fortifikimi prehistorik në Malin Kolaj, i vetmi i kësaj natyre i ndodhur në afërsi të grupit të tumave nga i të njëjtit fshat, por dhe i vetmi në gjithë kurrizin kodrinor të malit të Rrencit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë shtator 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

